

URDHËR
Nr. 314, datë 25.9.2020

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për trajtim dhe firmosje drejtorit të Përgjithshëm Rregullator dhe Përputhshmërisë për Rendin dhe Sigurinë Publike të praktikave të mëposhtme:

a) kërkesat drejtuar Shërbimit Informativ të Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtorive vendore të policisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit që aplikojnë për fitimin, rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare;

b) kthim përgjigjeje kërkesave të ndryshme të institucioneve dhe qytetarëve për çështjet që lidhen me shtetësinë;

c) kthimi i aplikimit të paraqitur në rastet e mungesës ose të pasaktësisë së dokumentacionit.

2. Delegimin e vulës, drejtorit të Përgjithshëm Rregullator dhe Përputhshmërisë për Rendin dhe Sigurinë Publike për praktikat e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Kompetencat, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 1.10.2020 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 218/1, datë 22.9.2017, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm Rregullator dhe Përputhshmërisë për Rendin dhe Sigurinë Publike për zbatimin e këtij urdhri.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj